

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit,
Raport 6 mujor i performancës (03.01.2017 -03.07.2017)

Datë 03.07.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit nga fushëveprimi i saj i përcaktuar, përveç aktiviteteve të rregullta në procedimin dhe zgjidhjen e kërkesave të ndryshme të parashtruara nga personat fizik dhe juridik zhvillon dhe një mori aktivitete tjera nga spektri i urbanizmit dhe mbrojtjes së mjedisit dhe bashkëvepron dhe asiston në aktivitetet e Drejtorive tjera. Nga aktivitetet e rregullta, Drejtoria zhvillon:

- Mbatja e takimeve të rregullta, ndarjen dhe shqyrtimi e mbi 600 kërkesave - lëndëve të parashtruara pranë DUMM-së gjatë kësaj periudhe dhe atyre të përcjellura nga vitit paraprak;
- Konsultimet e përditshme me qytetarë dhe dhënia e informatave lidhur me kërkesat e ndryshme;
- Takim me palët për të gjitha lëndët e rregullta dhe informim të përgjithshëm dhe;
- Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi me Drejtoritë Komunale për projektet kapitale ku pjesëmarrja e DUMM-së me fushëveprimin e sajë është i domosdoshëm;

Nga aktivitetet tjera të sektorin për urbanizëm, infrastrukturë dhe fusha e mbrojtjes së mjedisit:

- Ri Punimi i propozim Vendimit me plotësim të programit për menaxhimin dhe monitorimin e procedurës për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal;
- Ri Punimi i propozim Vendimit me plotësim të programit për menaxhimin dhe monitorimin e procedurës për hartimin e Hartës Zonale Komunale;
- Menaxhimi i Planit Rregullues të Hollësishëm "Qarshia e Madhe" dhe përgatitja e të njëjtit për trajtim në shqyrtim publik;
- Menaxhimi i Planit Rregullues të Hollësishëm "Rezine dhe Petro Nini Luarasi" – faza e profilit të zonës dhe përcaktimit të skenarëve për zhvillim të zonës;
- Përgatitjet për fillimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal në identifikimin dhe përfshirjen e çfarëdo dokumenti (Plane, projekte, strategji, studime, analiza, ekspertiza dhe të ngjashme) si: strategjitë sektoriale afatshkurta, afatmesme dhe afatgjata të nivelit lokal dhe qendror; strategjitë prej planeve të më parsh me komunale;

- strategjitë rajonale dhe strategjitë e komunave fqinje; udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat që burojnë nga konteksti | gjerë | planifikimit nga niveli lokal dhe qendror;
- Puna e përbashkët në Komisionin – Njësinë menaxhuese për funksionalizimin e ‘Qarshisë së Madhe’;
 - Puna e përbashkët në Komisionin për vënien nën mbrojtje të Malit Pashtrik dhe Ligenit të Vermicës;
 - Puna e përbashkët në Komisionin për vënien nën mbrojtje të Kanionit të Drinit të Bardhë;
 - Puna e përbashkët në Komisionin për Ri shqyrtimi dhe rivlerësimi | Listës – Objekteve të Trashëgimisë natyrore të Komunës së Gjakovës;
 - Puna e përbashkët në Komisionin me Departamentin e ujërave – pellgu | Drinit të Bardhë jemi në grupin punues për Zhvillim të Projektit ndërkombëtarë ndërkufitar “Enabling trans boundary cooperation and integrated water resources management in the extended Drini river basin”;
 - Puna e përbashkët në Grupin Punues për menaxhimin e hartimit të projekteve të rrugën në Komunën e Gjakovës;
 - Përcaktimin e kritereve për hapësirat reklamuese, për dhënien e tyre në shfrytëzim si dhe përpunimin e dokumenteve përkatëse për hapësirat e caktuara;
 - Përgatitja e materialit dhe dokumentacionit tjetër mbështetës në shpronësimin me vlerësim të parcelave dhe objektet e Kullës së Sylejman Vokshit dhe atyre përreth;
 - Përgatitja e materialit dhe dokumentacionit tjetër mbështetës për shpalljen e interesit publik dhe dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale;
 - Vazhdimësia në përgatitjen, mbledhja e të dhënave dhe konvertimi | Planeve Rregulluese Urbane në programin relevant për krijimin e bazës së të dhënave për hartimin e Hartës zonale Komunale;
 - Puna e përbashkët në Grupin Punues për menaxhimin dhe monitorimin e procesit të vendosjes së emërimit të rrugëve në Komunën e Gjakovës – projekt i donacioni i Bashkimit Evropian;
 - Puna në vazhdimësi për Sistemin e Adresave si koordinator i Grupit Punues, kur u punua në futjen e emërtimeve të reja në programin ARIS si dhe në digjitalizimin e tabelave të rrugëve i nevojshëm për projektin e vendosjes së tyre si dhe vendosjen e tabelave të rrugëve në Komunën e Gjakovës (në procedim të sipër);
 - Përgatitja e projekteve, mbledhja e të dhënave për nevojat e dizajnit të kolektorëve kryesorë të qytetit dhe impiantit të pastrimit të ujerave të zeza;
 - Takim pune me përfaqësuesit e KEDS – zyrës qendrore lidhur me projektet strategjike të energjetikës për komunën tonë,

- Takime pune me përfaqësuesit e DSHP, Inspektionit dhe për çështjen e gjobave mandatorë;
- Përgatitja e shënimeve dhe kritereve për dhënien në shfrytëzim të panove reklamuese dhe billboard në qytetin e Gjakovës,
- Pjesëmarrja në hartimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave, punimi i tij, organizimi i debateve publike dhe bashkëpunimi me programin e DEMOS-it;
- Pjesëmarrja në hartimin e dhe përcaktimin e prioriteteve në komponentë në fuqizimit të ligjit me organizatën DEMOS;
- Monitorimi i gjendjes së mjedisit aktivitet | rregullt periodik;
- Menaxhimi | trajtimit të mjedisit në proceset e hartimit të Planeve Rregulluese Të Hollësishme Urbane;
- Organizimi dhe koordinimi i aktivitetit të rregullt vjetor “Ta pastrojmë Gjakovën”;
- Eksplorimi, analiza dhe përcaktimi i lokacioneve për pikat grumbulluese të mbeturinave tek objektet banim ore shumë banesore;
- Pjesëmarrja permanente në Komisionin për trajtimin dhe miratimin e Raporteve për Leje mjedisore Komunale;
- Pjesëmarrja permanente me Komision dhe përgatitja e mendimeve profesionale lidhur me parcelat e kompleksit Rezine veriore;
- Pjesëmarrja permanente në Komisionin për banim social dhe përcaktimit të përfitueseve të të njëjtit program;
- Pjesëmarrja permanente në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave;
- Pjesëmarrja dhe angazhimi i zyrtarëve në Komisionet e caktuara nga Bordi i Drejtorëve për çështje të ndryshme.

U.D. Drejtorit:

Elida Bejtullahu inxh.dip.ark

Bashkangjitur e gjeni dhe raportin numerik të lëndëve të trajtuara në DUMM.